

AKTI I THEMELIMIT I SHOQËRISË ME PERGJEGJESI TË KUFIZUAR "TECHBRAINCHILD DIGITAL SOLUTIONS" SHPK	DEED OF INCORPORATION OF THE LIMITED LIABILITY COMPANY "TECHBRAINCHILD DIGITAL SOLUTIONS" SHPK
<p>Neni 1 Ortakët themelues 1.1. Shoqëria "TechBrainchild Digital Solutions" SHPK themelohet sot më 26/05/2024 nga Aeniks B.V., shoqëri e të drejtës holandeze me seli në Eindhoven, Holandë, numër regjistri 89806557, përfaqësuar ligjërisht nga Drejtorët Menaxhues Z. Ermal Nikollari dhe Znj. Anisa Nikollari;</p>	<p>Art. 1 Constituent shareholders 1.1 The company "TechBrainchild Digital Solutions" SHPK is established on 26/05/2024 by Aeniks B.V. a Dutch company, registered in Eindhoven, The Netherlands with CCI number 89806557, legally represented by the Managing Directors Mr. Ermal Nikollari and Ms. Anisa Nikollari:</p>
<p>Neni 2 Emërtimi 2.1. Emërtimi i shoqërisë është "TechBrainchild Digital Solutions" SHPK (në vijim do të quhet "Shoqëria").</p>	<p>Art. 2 Name 2.1 The name of the company is "TechBrainchild Digital Solutions" SHPK (the "Company").</p>
<p>Neni 3 Forma ligjore 3.1. Shoqëria është e formës me përgjegjësi të kufizuar dhe është themeluar në përputhje me dispozitat e legjislacionit tregtar në Shqipëri. 3.2. Shoqëria mund të shndërrohet në një formë tjetër ligjore në përputhje me legjislacionin shqiptar.</p>	<p>Art. 3 Legal form 3.1 The Company is a limited liability company and is established in accordance with the provisions of Albanian commercial legislation. 3.2 The Company can transform its legal form in compliance with the Albanian legislation in force.</p>
<p>Neni 4 Baza ligjore 4.1. Shoqëria do të zhvillojë veprimtarinë e saj në përputhje me këtë Akt Themelimi dhe legjislacionin tregtar dhe dispozitat ligjore në fuqi. 4.2. Organizimi dhe funksionimi i Shoqërisë rregullohen nga Statuti i cili miratohet nga Ortaku i Vetëm.</p>	<p>Art. 4 Applicable law 4.1 The company will carry out its business in compliance with this Deed of Incorporation and with commercial regulations and laws in force. 4.2 The organization and functioning of the Company are regulated by the Articles of Association approved by the Sole Shareholder.</p>
<p>Neni 5 Personaliteti juridik. Kohëzgjatja 5.1. Shoqëria fiton personalitet juridik me regjistrimin e saj në Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit në Tiranë, Shqipëri. 5.2. Afati i veprimtarisë është i pakufizuar.</p>	<p>Art. 5 Legal personality. Duration 5.1 The Company's legal personality will begin with its registration at the National Business Center in Tirana, Albania. 5.2 The duration of the Company is indefinite.</p>
<p>Neni 6 Selia 6.1. Selia e shoqërisë është në Rr. Abdyl Frasheri 8, Hyrja 7, Kati 8, Ap. 25, 1019 Tirane, Albania</p>	<p>Art. 6 Legal seat 6.1 The company's legal seat is at Rr. Abdyl Frasheri 8, Hyrja 7, Kati 8, Ap. 25, 1019 Tirane, Albania.</p>
<p>Neni 7 Objekti i veprimtarisë 7.1. Objekti i shoqërisë është dizajn dhe zhvillim software, web, dhe cloud, shërbime të ndryshme dixhitale si marketing dixhital, menaxhim i mediave sociale, shërbime SEO dhe SEM, etj.</p>	<p>Art. 7 Object of activity 7.1 The object of activity is web, cloud, and software development & design, and provision of digital services such as digital marketing, social media management, SEO and SEM services.</p>
<p>Neni 8 Kapitali themeltar 8.1. Kapitali themeltar është 1.000.000 (një milion) lekë. 8.2. Kapitali është i ndarë në 1 (një) kuotë e cila përbën 100% të kapitalit.</p>	<p>Art. 8 Share capital 8.1 The share capital is 1.000.000 (one million) lekë. 8.2 The share capital is divided into 1 (one) share equal to 100% of the share capital.</p>
<p>THEMELUESI AENIKS B.V. <i>Ermal Nikollari</i> <i>Ermal Nikollari</i></p>	<p>THE FOUNDER AENIKS B.V. <i>Ermal Nikollari</i> <i>Ermal Nikollari</i></p>

<p style="text-align: center;">STATUTI I SHOQËRISË ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR "TECHBRAINCHILD DIGITAL SOLUTIONS" SHPK</p>	<p style="text-align: center;">ARTICLES OF ASSOCIATION OF THE LIMITED LIABILITY COMPANY "TECHBRAINCHILD DIGITAL SOLUTIONS" SHPK</p>
<p>EMËRTIMI, FORMA LIGJORE, KOHEZGJATJA, SELIA, OBJEKTI</p>	<p>NAME, LEGAL FORM, DURATION, HEADQUARTERS, OBJECT</p>
<p>Art. 1 Emërtimi 1.1 Emërtimi i shoqërisë është "TechBrainchild Digital Solutions" SHPK (në vijim do të quhet "Shoqëria").</p>	<p>Art. 1 Name 1.1 The name of the company is "TechBrainchild Digital Solutions" SHPK (hereinafter "The Company").</p>
<p>Art. 2 Forma ligjore 2.1 Shoqëria është e formës me përgjegjësi të kufizuar dhe është themeluar në përputhje me dispozitat e legjislacionit tregtar në Shqipëri. 2.2 Shoqëria mund të shndërrohet në një formë tjetër ligjore në përputhje me legjislacionin shqiptar.</p>	<p>Art. 2 Legal form 2.1 The Company has the form of a limited liability company and was established in accordance with the provisions of Albanian commercial legislation. 2.2 The company can transform its legal form in compliance with the Albanian legislation in force.</p>
<p>Art. 3 Baza ligjore 3.1 Shoqëria do të zhvillojë veprimtarinë e saj në përputhje me këtë Statut, legjislacionin tregtar dhe dispozita të tjera ligjore në fuqi. 3.2 Për sa nuk është parashikuar në këtë Statut, do të aplikohen dispozitat e ligjit nr. 9901, datë 14 prill 2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar.</p>	<p>Art. 3 Applicable law 3.1 The company will carry out its business in compliance with these Articles of Association and with commercial regulations and laws in force. 3.2 For anything not provided for by these Articles of Association, the provisions of law no. will be applied. 9901, of 04.14.2008, "On traders and commercial companies".</p>
<p>Art. 4 Personaliteti juridik. Kohëzgjatja 4.1 Shoqëria fiton personalitet juridik me regjistrimin e saj në Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit në Tiranë, Shqipëri. 4.2 Afati i veprimtarisë është i pakufizuar.</p>	<p>Art. 4 Legal personality. Duration 4.1 The company's legal personality will begin with its registration at the National Business Center in Tirana, Albania. 4.2 The duration of the Company is indefinite.</p>
<p>Art. 5 Selia 5.1 Selia e Shoqërisë është në adresën: Rr. Abdyl Frasheri 8, Hyrja 7, Kati 8, Ap. 25, 1019 Tiranë, Shqipëri. 5.2 Transferimi i selisë së Shoqërisë në një adresë tjetër do të bëhet vetëm me vendimin e Asamblesë së Ortakeve. 5.3 Shoqëria mund të hapë degë, filiale apo zyra përfaqësie si brenda territorit të Shqipërisë ashtu dhe jashtë saj. 5.4 Shoqëria mund të marrë pjesë në shoqëri të tjera që ekzistojnë ose do të krijohen në të ardhmen si në shtetin Shqiptar ashtu edhe në shtete të tjera.</p>	<p>Art. 5 Legal seat 5.1 The company's legal seat is at the address Rr. Abdyl Frasheri 8, Hyrja 7, Kati 8, Ap. 25, 1019 Tirane, Albania. 5.2 The transfer of the Company's headquarters to another location will take place with the resolution of the General meeting. 5.3 The company may establish secondary offices, branches within the territory of the Albanian state and abroad. 5.4 The company can take part, in another existing company, or one that will be established in the future both within the territory of the Albanian state and abroad.</p>
<p>Art. 6 Objekti i veprimtarisë 6.1 Objekti i shoqërisë është dizajn dhe zhvillim software, web, dhe cloud, shërbime të ndryshme dixhitale si marketing dixhital, menaxhim i mediave sociale, shërbime SEO dhe SEM, etj.</p>	<p>Art. 6 Object of activity 6.1 The company's object of activity is activity is web, cloud, and software development & design, and provision of digital services such as digital marketing, social media management, SEO and SEM services.</p>

E. N. Zemel Nikollari

KAPITALI, KUOTAT	SHARE CAPITAL, SHARES
<p>Art. 7 Kapitali themeltar</p> <p>7.1 Kapitali themeltar është 1.000.000 (një milionë) lekë.</p> <p>Kapitali themeltar përbëhet nga 1 (një) kuotë, plotësisht e nënshkruar, me vlerë nominale sipas kontributit të ortakëve në kapitalin themeltar të shoqërisë.</p> <p>7.2 Kuota e kapitalit themeltar zotërohen nga ortaku i vetëm Aeniks B.V., e cila zotëron 1 (një) kuotë me vlerë nominale 1.000.000 (një milionë) lekë, e cila përbën 100% të kapitalit të shoqërisë.</p> <p>7.3 Përgjegjësia e Ortakëve shtrihet deri në vlerën e kontributit të tyre në kapitalin e Shoqërisë.</p>	<p>Art. 7 Share capital</p> <p>7.1 The share capital is 1.000.000 (one million) lekë.</p> <p>7.2 The share capital is made up of 1 (one) fully subscribed share, having the nominal value as per the contributions of the shareholders in the share capital of the company.</p> <p>7.3 The share capital is owned by the Sole Shareholder Aeniks B.V., that owns 1 (one) share in the nominal value of 1.000.000 (one million) lekë, equal to 100% of the share capital.</p> <p>7.4 The responsibility of the shareholders extends up to the value of their contribution to the share capital.</p>
<p>Art. 8 Rritja e kapitalit themeltar</p> <p>8.1 Kapitali themeltar mund të rritet pa kufi në çdo moment, një ose disa herë, me vendim të Asamblesë së Ortakëve.</p> <p>8.2 Në rast rritjeje të kapitalit, të gjithë ortakët kanë të drejtën të nënshkruajnë rritjen në raport me vlerën nominale të kuotës së kapitalit të zotëruar. Në rast se disa nga ortakët nuk e ushtrojnë këtë të drejtë, pjesët e tyre mund të nënshkruhen nga ortakët e tjerë proporcionalisht me vlerën nominale të kuotës së kapitalit të zotëruar prej tyre.</p>	<p>Art. 8 Increase in share capital</p> <p>8.1 The share capital may be increased without limits at any time in one or more times, with the resolution of the General meeting.</p> <p>8.2 In the event of a resolution to increase the share capital, all shareholders have the right to subscribe to the increase in proportion to the nominal value of the share of capital held. If they do not exercise this right, their shares may be subscribed by the other shareholders in proportion to the nominal value of the capital share held.</p>
<p>Art. 9 Zvogëlimi i kapitalit themeltar</p> <p>9.1 Shoqëria mund të zvogëlojë kapitalin themeltar me vendimin e Asamblesë së Ortakëve. Në çdo rast kapitali themeltar nuk mund të zvogëlohet nën kufijtë e parashikuar nga ligji.</p> <p>9.2 Zvogëlimi i kapitalit përballohet nga secili prej ortakëve në të njëjtën masë me vlerën nominale të kuotës së kapitalit të zotëruar.</p>	<p>Art. 9 Reduction of share capital</p> <p>9.1 The Company may reduce the share capital following a resolution of the General meeting. In any case, the share capital cannot be reduced below the minimum required by law.</p> <p>9.2 The reduction in capital is borne by each shareholder in proportion to the nominal value of the share of capital owned.</p>
<p>Art. 10 Transferimi i kuotave</p> <p>10.1 Kuotat janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve.</p> <p>10.2 Në rast transferimi në çdo lloj forme, si me shpërbllim ashtu edhe pa shpërbllim në kuptimin me të gjere të fjalës, duke përfshirë këtu edhe dhurimin në favor të subjekteve të tjerë të ndryshëm nga ortakët, kuotat duhet me pare t'i ofrohen në parablerje ortakëve të tjerë.</p> <p>10.3 Në një rast të tillë ortaku që do të transferojë kuotën e tij duhet të njoftojë ortakët e tjerë, me letër rekomande me kthim përgjigje, mbi synimin për shitje, duke përcaktuar çmimin, kushtet, modalitetet, emrin e blerësit dhe afatet e transferimit. E drejta e parablerjes duhet t'i referohet të gjithë kuotës të ofruar për shitje.</p> <p>10.4 Ortakët do të kenë në dispozicion 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga marrja e letrës rekomande, për t'i komunikuar ortakut që transferon kuotat,</p>	<p>Art. 10 Transfer of shares</p> <p>10.1 The shares are freely transferable between the shareholders of the company.</p> <p>10.2 In the event of a transfer for any reason, whether onerous or free in the broadest sense of the term, including therefore the donation of the company shares to subjects other than the shareholders, the shares must be offered with pre-emption to the other shareholders.</p> <p>10.3 In this case, the selling shareholder must communicate in writing to the other shareholders, by registered mail with return receipt, the intention to sell, indicating the price, conditions, methods, name of the buyer and terms of the sale. The right of pre-emption must in any case refer to the entire quota offered for sale.</p> <p>10.4 The shareholders will have 15 (fifteen) days, from receipt of the registered letter with return receipt, to communicate to the selling shareholder their</p>

E. N. Zmel Nikollari

<p>synimin e tyre për të ushtruar apo jo të drejtën e parablerjes. Në rast se ata nuk përgjigjen në afatin e caktuar, prezumohet se kanë hequr dorë nga e drejta e parablerjes.</p> <p>10.5 Në rast se oferta pranohet nga disa ortakë, kuota e ofruar nga ortaku që e transferon atë, do të ndahet midis ortakëve pranues, në të njëjtën masë me vlerën nominale të kuotës së kapitalit që ata zotërojnë, përveç rastit kur ka një marrëveshje të kundërt. Në asnjë rast, pranuesi i ofertës nuk mund të ushtrojë pjesërisht të drejtën e parablerjes.</p> <p>10.6 Nëse një ose disa ortakë synojnë të blejnë, por me një çmim më të ulët se ai i treguar çmimi do të përcaktohet (për të gjithë ofertuesit), me anë të një raport-vlerësimi të betuar nga një ekspert i caktuar nga të gjitha palët e interesuara. Në rast se palët nuk arrijnë të emërojnë një ekspert të përbashkët, eksperti do të emërohet nga gjykata e Tiranës</p> <p>10.7 Në rast se e drejta e parablerjes nuk ushtrohet, kuotat mund t'u transferohen plotësisht apo pjesërisht të tretëve, me vendimin pozitiv të Asamblesë së Ortakëve.</p>	<p>eventual desire to exercise their right of pre-emption or not. Upon expiry of the established term, the right of pre-emption in their favor is considered waived.</p> <p>10.5 In the event that the offer is accepted by more than one shareholder, the share of the selling shareholder will be divided among the acceptors in proportion to the nominal value of the share capital held by each of them, unless otherwise agreed between the parties. Under no circumstances will the bidder be required to accept only a partial exercise of the right of pre-emption.</p> <p>10.6 If one or more shareholders intend to purchase, but at a price lower than that indicated, the price will be determined (for all bidders) through a sworn estimate report by a common expert appointed and accepted by all interested parties. In case the parties are unable to appoint a common expert, the expert will be appointed by the court of Tirana.</p> <p>10.7 In case of failure to exercise the right of pre-emption, the shares may be transferred to third parties in whole or in part, subject to a positive resolution of the General meeting.</p>
<p>ORGANET E SHOQËRISË</p>	<p>CORPORATE BODIES</p>
<p>Art. 11 Asambleja e ortakëve</p>	<p>Art. 11 General meeting</p>
<p>11.1 Organi vendimmarrës i Shoqërisë është Asambleja e Ortakëve.</p> <p>11.2 Asambleja e Ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për çështjet vijuese, por pa u kufizuar në to, vendimet me poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë dhe mbikëqyrjen e zbatimit të tyre nga administratoret, përfshirë raportet financiare; - rritjen dhe zvogëlimin e kapitalit; - shkriren/bashkimin me shoqëri të tjera; - ndryshimin e statutit të shoqërisë; - ndryshimin e selisë dhe të emërimit të shoqërisë; - emërimin e ekspertëve kontabël të autorizuar, në qoftë se është e nevojshme; - shitjen ose transferimin e pjesëve të kapitalit themeltar palëve të treta; - ristrukturimin dhe prishjen shoqërisë; - emërimin ose shkarkimin e administratorit ose administratorëve të shoqërisë; - miratimin e pasqyrave financiare të shoqërisë dhe raportit të administratorit(eve); - vendimin për shpërndarjen e fitimit dhe mbulimin e humbjeve; - transformimin e shoqërisë në forma të tjera ligjore; - dhe çdo lëndë tjetër të parashikuar nga Statuti ose nga ligji. 	<p>11.1 The decision-making body of the Company is the General meeting.</p> <p>11.2 The General meeting is responsible for, by way of example but not limited to, decisions regarding the following matters:</p> <ul style="list-style-type: none"> - approving the company's commercial policies and supervising their execution by the director or directors, including financial reports; - increase and reduction of share capital; - dissolution/merger with other companies; - modification of the Articles of Association; - change of registered office and company name; - appoints authorized accounting experts if necessary; - sale or transfer of shares of the share capital to other parties; - restructuring and dissolution of the company; - appointment and revocation of the director or directors of the company; - approval of the company's financial statements and the report of the director or directors; - decision on profit distribution and loss coverage; - transformation of the legal form of the company; - other matters provided for by the Articles of Association or by law.

E. N. Zemel Nikollari

11.3	Çdo ortak ka të drejtë të marrë pjesë në Asamble, të paraqesë mendimin e tij dhe të japë vota në proporcion me vlerën nominale të kuotës së kapitalit që ai zotëron.	11.3	Each shareholder has the right to participate in General meetings, to present their opinion and to express their votes in proportion to the nominal value of the share capital held.
11.4	Çdo ortak ka të drejtë të përfaqësohet nga një person tjetër jo-ortak, i pajisur me prokurë me shkrim, me anën e së cilës mund të japë votën e tij.	11.4	Each shareholder has the right to be represented by another person, even if not a shareholder, with a simple written proxy, through which they can express their vote.
11.5	Ortaku nuk mund të lëshojë prokurë për votim për një pjesë të kapitalit që zotëron, në qoftë se voton personalisht për pjesën e mbetur.	11.5	The shareholder cannot grant any proxy to vote for a part of his capital if he votes in person for the remaining part.
Art. 12 Thirrja e Asamblesë së Ortakëve, Kuorumi dhe Vendimet		Art. 12 Meeting notice, quorum and resolutions	
12.1	Asambleja e Ortakëve thirret të paktën një herë në vit, brenda 90 (nëntëdhjetë) ditëve kalendrike nga mbyllja e vitit financiar për miratimin e bilancit, të raportit të Administratorit, dhe/ose të ekspertit kontabël.	12.1	The General meeting must be convened at least once a year within 90 (ninety) calendar days from the end of the financial year for the approval of the financial statements, the reports of the Directors and/or the accounting expert.
12.2	Asambleja mund të thirret në çdo moment nga një prej Administratoreve si dhe prej një ose disa ortakëve që përfaqësojnë të paktën 5% (pese për qind) të kapitalit themeltar. Asambleja duhet të thirret nëpërmjet njoftimit me letër rekomande me kthim përgjigje që duhet t'u dërgohet ortakëve - në adresën që rezulton sipas këtij Statuti - dhe ekspertit kontabël (nëse është emëruar), të paktën 7 (shtate) dite përpara mbledhjes së Asamblesë. Thirrja duhet të përmbajë informacion mbi llojin e Asamblesë, mbi çështjet që do të trajtohen dhe për të cilat do të merret vendim, mbi vendin, orën dhe datën e thirrjes së parë dhe të dytë.	12.2	The General meeting can also be called at any time by one of the Directors as well as by one or more shareholders representing at least 5% (five percent) of the share capital. The General meeting must be convened by registered letter with return receipt sent to the shareholders - in the domicile resulting from these Articles of Association - and to the accounting expert (if appointed) at least 7 (seven) days before the day set for the General meeting. The notice must contain an indication of the type of General meeting, the matters to be discussed and resolved, the place, time and date of the first and second call.
12.3	Asambleja mund të thirret edhe jashtë selisë së Shoqërisë.	12.3	The General meeting can also be convened outside the registered office.
12.4	Në rast se Asambleja e Ortakëve nuk mbledhet me thirrjen e parë për mungesën e kuoromit të parashikuar në pikën 12.7 të këtij Statuti, Asambleja e Ortakëve do të thirret brenda 30 (tridhjetë) ditësh me të njëjtin rend dite.	12.4	In case of failure to meet the General meeting on the first call due to lack of quorum provided for in paragraph 12.7 of these Articles of Association, the General meeting will be convened within 30 (thirty) days with the same agenda.
12.5	Mbledhjet e Asamblesë mund të mbahen edhe nëpërmjet telekonferencës dhe videokonferencës, me kusht që të gjithë pjesëmarrësit të mund të identifikohen dhe t'u lejohet atyre të ndjekin diskutimin dhe të ndërhyjnë në momentin e trajtimit të çështjeve në rend të ditës; pasi të jenë verifikuar këto kërkesa që duhet të rezultojnë në procesverbalin e mbledhjes, Asambleja konsiderohet e mbajtur në vendin ku ndodhet Kryetari në të cilin duhet të ndodhet edhe Sekretari i mbledhjes.	12.5	The possibility of General meetings being held by teleconference and videoconference is permitted, provided that all participants can be identified and are allowed to follow the discussion and intervene in real time in the discussion of the topics addressed; If these requirements are met, which must appear in the minutes of the meeting, the General Meeting is considered to be held in the place where the President is located and where the Secretary of the meeting must also be located.
12.6	Asambleja do të thirret dhe mbahet rregullisht edhe pa respektimin e formaliteteve të njoftimit nëse janë të pranishëm ortakët që përfaqësojnë të tere kapitalin themeltar.	12.6	The General meeting will be considered duly convened and constituted even without compliance with the convocation formalities if the entire share capital is present or represented.
12.7	Vendimet e Asamblesë së ortakëve, për të cilat kërkohet një shumicë e thjeshtë, janë të vlefshme nëse janë të pranishëm ortakët me të drejtë vote	12.7	The resolutions of the General meeting, which require a simple majority, are valid if shareholders with voting rights representing more than 30%

E. N. Zmel Nikolla

	që zotërojnë me shume se 30% (tridhjetë) te kapitalit themeltar. Vendimet e Asamblesë se Ortakeve që kërkojnë një shumice te cilësuar, janë te vlefshme nëse janë te pranishëm ortaket me te drejte votë që zotërojnë të paktën 51% (pesëdhjetë e një për qind) të kapitalit themeltar.		(thirty percent) of the entire share capital are present. The resolutions of the General meeting, which require a qualified majority, are valid if shareholders with voting rights representing at least 51% (fifty-one percent) of the entire share capital are present.
12.8	Asambleja e Ortakeve vendos lidhur me ndryshimet e statutit, zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit te shoqërisë, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë, me votën pro që përfaqëson te paktën $\frac{3}{4}$ (tre te katërtat) e ortakeve te pranishëm që zotërojnë te paktën 51% (pesëdhjetë e një për qind) te kapitalit themeltar. Në të gjitha rastet e tjera, Asambleja e Ortakeve merr vendime me shumice te thjeshte te votave te ortakeve që prezent në mbledhje.	12.8	The General meeting decides on the modification of the Articles of Association, the increase and decrease of the capital, the distribution of the profits, the reorganization and the dissolution of the company with the favorable vote of the shareholders representing at least $\frac{3}{4}$ (three quarters) of the votes of the shareholders present, which represent at least 51% (fifty-one percent) of the entire share capital. In all other cases, the General meeting decides in ordinary session with a simple majority of the votes of the shareholders present.
12.9	Çdo mbledhje Asambleje drejtohet nga një ortak ose ndonjë person tjetër i caktuar nga vete Asambleja. Për pasqyrimin e vendimit Asambleja emëron një Sekretar, që mund të jetë edhe jo-ortak.	12.9	Each meeting is chaired by a shareholder or other person designated by the General Meeting itself. For the minutes, the General meeting appoints a Secretary, even if he is not a shareholder.
12.10	Vendimet e Asamblesë së Përgjithshme duhet të nënshkruhen nga Kryetari i Asamblesë dhe nga Sekretari.	12.10	The resolutions of the General meeting must be signed by the President of the General meeting and the Secretary.
12.11	Në rast se Shoqëria ka një ortak të vetëm, kompetencat e Asamblesë së Përgjithshme do të ushtrohen nga ortaku i vetëm.	12.11	In the event that the Company has a Sole shareholder, the General meeting is exercised by the Sole shareholder.
Art. 13 Administrimi		Art. 13 Administration	
13.1	Administrimi i shoqërisë do te kryhet nga një ose më shumë administratorë që emërohen me vendim të Asamblesë së Ortakëve.	13.1	The Company is managed by one or more directors appointed by resolution of the General meeting.
13.2	Nëse Shoqëria administrohet nga më shumë se një administrator, atëherë Administratorët mund t'i ushtrojnë kompetencat bashkërisht ose veçmas sikurse do të përcaktohet në vendimin përkatës të Asamblesë së Ortakëve.	13.2	If the Company is managed by more than one director, the directors will be able to exercise their powers and duties, jointly or separately, as provided for by the resolution of the General Meeting.
13.3	Mandati i administratorit do të jetë i vlefshëm për pesë vjet me të drejtë ripërtëritje ose deri në çastin e revokimit të tij me vendim të Asamblesë së Ortakëve.	13.3	The director remains in office until his dismissal or revocation of the mandate by the General Meeting or for a period of five years.
13.4	Administratori i Shoqërisë mund t'i transferojë çdo personi apo grupi personash të gjitha apo një pjesë të kompetencave të tij sipas këtij Statuti dhe me kushtet që ai konsideron si të arsyeshme dhe në çdo kohë mund të anulojë këtë transferim kompetencash.	13.4	The administrator may transfer to another person or group of persons, all or part of his powers according to these Articles of Association and under the conditions he considers reasonable, a transfer which he may decide to cancel at any time.
13.5	Përfaqësimi ligjor i Shoqërisë i besohet Administratorit. Administratori do të ushtrojë gjitha kompetencat konform me sa parashikohet në nenin 95 te Ligjit nr. 9901 të datës 14.04.2008 "Për tregtarët dhe Shoqëritë tregtare", përveç sa parashikohet në nenin 14.6 në vijim.	13.5	The legal representation of the Company lies with the director. The director will be able to exercise all powers in accordance with the provisions of article 95 of law no. 9901 of 14.04.2008 "For Merchants and Commercial Companies", except as provided in the following article 14.6.
13.6	Administrator i parë i shoqërisë emërohet:	13.6	The first director of the company is appointed:

E. N. Zmel Nikollari

<p>Z. Ermir Agaçi, shtetas shqiptar, lindur në Tiranë më 19/10/1979, me banim në Rr. Katër Dëshmorët 26, H.1 Ap. 9, kodi postar 1017, Tiranë, mbajtës i letërnjoftimit ID nr. H91019041L;</p>	<p>Mr. Ermir Agaçi, Albanian citizen, born in Tirana on 19/10/1979, residing at Rr. Katër Dëshmorët 26, H.1 Ap. 9, kodi postar 1017, Tiranë, holder of the ID card no. H91019041L;</p>
<p>Art. 14 Viti financiar 14.1 Viti financiar përputhet me vitin kalendarik, duke filluar nga 1 Janari dhe përfundon më 31 Dhjetor të çdo viti. 14.2 Përrjashtimisht, viti i parë financiar do të fillojë nga dita e regjistrimit të Shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit dhe përfundon më 31 Dhjetor të po atij viti.</p>	<p>Art. 14 Financial year 14.1 The financial year corresponds to the calendar year, starting on January 1st and ending on December 31st of each year. 14.2 Exceptionally, the first financial year begins on the day of registration of the company with the National Registration Center and ends on 31 December of the same year.</p>
<p>Art. 15 Bilanci. Kontabiliteti 15.1 Bilanci vjetor i Shoqërisë shqyrtohet nga Asambleja e Ortakëve dhe duhet të përgatitet për t'u paraqitur para organeve tatimore deri në fund të muajit Mars të çdo viti pasardhës. 15.2 Kontabiliteti mbahet në gjuhën dhe monedhën shqiptare si dhe sipas kërkesave të legjislacionit përkatës. Për operacione të veçanta, shoqëria mund të bëjë veprime edhe me llogari të veçanta në monedhë të huaj, duke bërë konvertimin brenda vitit. 15.3 Shoqëria mund të pranojë fonde nga institucionet financiare që operojnë në Shqipëri ose jashtë. Për këtë qëllim shoqëria mund të lërë peng pjesë të kapitalit si garanci ose mund të hipotekojë pasuritë e saj të paluajtshme, vetëm me vendim të Asamblesë së Ortakëve.</p>	<p>Art. 15 Account books. Accounting 15.1 The Company's account books must be approved by the General Meeting and are presented to the tax by the end of March of the following year. 15.2 Accounting is expressed in the Albanian language and currency according to the provisions of the law in force. In particular cases, the company can also operate a current account in foreign currency, then converting the sum within the year. 15.3 The Company can receive financing from financial institutions operating in Albania or abroad. For this purpose, the company can pledge or register a mortgage on its real estate assets only by resolution of the General Meeting.</p>
<p>Art. 16 Te ardhurat, dividendi 16.1 Fitimet që do të rezultojnë në fund të mbylljes së çdo viti ushtrimor, pas pagimit të tatimeve, mund të ndahen nga Asambleja e Ortakëve.</p>	<p>Art. 16 Income, Dividends 16.1 The profits made at the end of each financial year, after having paid the tax due, can be distributed by the General Meeting.</p>
<p>Art. 17 Likuidimi 17.1 Shoqëria priset me përfundimin e afatit të parashikuar nga Statuti, ose përpara përfundimit në rastet e parashikuara nga ligji, ose me anë të një vendimi të Asamblesë së Ortakëve, me shumicën e kërkuar për ndryshimet në statut. 17.2 Shoqëria nuk priset në rast të humbjes së zotësisë për të vepruar, vdekjes, ose falimentimit të ortakëve. 17.3 Në rast prishje, Shoqëria duhet të likuidohet. Për të administruar këtë procedurë, Asambleja emëron një ose me shumë likuidatorë, të cilët paraqesin raportet përfundimtare mbi gjendjen e aktivitetit dhe pasivitetit të Shoqërisë, mbi operacionet e likuidimit dhe mbi kohën e nevojshme për të përfunduar likuidimin. 17.4 Me përfundimin e procedurës së likuidimit, Asambleja do të vendosë mbi bilancin financiar përfundimtar, mbi punën e kryer nga likuiduesi dhe mbi përfundimin e procesit të likuidimit. 17.5 Pas pagimit të kreditorëve dhe mbledhjes së kredive, likuidatori do t'i shpërndajë të ardhurat</p>	<p>Art. 17 Dissolution. Liquidation 17.1 The Company is dissolved upon expiry of the duration according to the Articles of Association or before this deadline in the cases provided for by law or by decision of the General Meeting, with the majority required for the modification of the Company's Articles of Association. 17.2 The Company does not dissolve in the event of incapacity, death or bankruptcy of the shareholders. 17.3 In the event of dissolution, the Company will be placed into liquidation. To manage this procedure, the General Meeting will appoint one or more liquidators who will present the final report on the status of the Company's assets and liabilities on the liquidation operations and on the times necessary to complete the liquidation. 17.4 At the end of the liquidation procedure, the General Meeting will decide on the final accounts, on the work carried out by the liquidator and on the end of the liquidation. 17.5 After the payment of creditors and the collection of debts, the liquidator will distribute the final</p>

E. N. Zemel Nikollari

<p>përfundimtare te likuidimit ortakeve, ne proporcion me vlerën nominale te kuotës te zotëruar prej tyre ne kapitalin themeltar.</p> <p>Art. 18 Mosmarrëveshjet</p> <p>18.1 Çdo mosmarrëveshje që mund të lind në lidhje me zbatimin dhe/ose me interpretimin e këtij Akt themelimi dhe Statuti, do të zgjidhet nga gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.</p> <p>18.2 Mosmarrëveshjet që mund të lindin midis shoqërisë dhe të tretëve, në rast se nuk zgjidhen me mirëkuptim do t'i nënshtrohen shqyrtimit nga gjykata kompetente shqiptare.</p> <p>Art. 19 Klauzolë mbyllëse</p> <p>19.1 Ky Statut hartohet në 3 (tre) ekzemplare me fuqi të njëjtë ligjore.</p> <p>19.2 Për të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me interpretimin dhe/ose zbatimin e këtij Statuti, versioni në shqip do të jete i vetmi që do të jetë ligjërisht detyrues.</p> <p>ORTAKU</p> <p>AENIKS B.V.</p> <p><i>Ermal Nikollari</i></p> <hr/> <p><i>Zemal Nikollari</i></p> <p>26.05.2024</p>	<p>proceeds of the liquidation to the shareholders in proportion to the nominal value of the share of capital owned.</p> <p>Art. 18 Disputes</p> <p>18.1 Any dispute that may arise from the execution and/or interpretation of the Deed of Incorporation and the Articles of Association will be resolved by the District Court of Tirana.</p> <p>18.2 Disputes that may arise between the company and third parties, if not resolved through compromise, will be submitted to the jurisdiction of the competent Albanian court.</p> <p>Art. 19 Closing clause</p> <p>19.1 These Articles of Association are drawn up in three (3) copies with the same legal value.</p> <p>19.2 For all disputes that may arise relating to the interpretation of the aforementioned acts and documents, the Albanian version will be the only legally binding one.</p> <p>THE SHAREHOLDER</p> <p>AENIKS B.V.</p> <p><i>Ermal Nikollari</i></p> <hr/> <p><i>Zemal Nikollari</i></p> <p>26.05.2024</p>
--	---